



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

**Data: 22.05.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje kontejnere per mbledhjen e mbeturinave.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Kontenierë për mbeturina (44613800-8).

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1.350.720** (Nje milion e treqind e pesedhete mije e shtateqind e njezete) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA DIBER ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e ofertes sipas shtojces 1:*

*b. Lista e cmimeve te artikujve sipas shtojces 2;*

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8:

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, pika 1, 82 pika 1 dhe 83 pika 1 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, të LPP, *ky kriter kerkohet sepse verteton se opertoret ekonomik kane kapacitetet e duhura ligjore per kryerjen e furnizimeve te mallrave*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2020,2021 dhe 2022 ku vlera mesatare e të tre viteve të jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Ky kriter vendoset per te siguruar opertoret ekonomik kapacitetet financiare te duhura per permbushjen e kushteve te kontrates.**

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni nenin 43 pika 2 germa c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet:

***c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.***

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021 dhe 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te

*miratuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë të përcaktuara në aktmarreveshje.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3.** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

*Shenim: Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kesaj kontrate.

**Per te vertetuar pervojen e meparshme te ngjashme, operatoret ekonomik duhet te paraqesin deshmita si meposhte:**

**2.3.1.a** *Per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohet vlera, afati I perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore e shitjes te plotesuara sipas legjislacionit ne fuqi, ku shenohet data, shuma, dhe sasite e mallrat e furnizuara.*

**Ose**

**2.3.1.b** *Per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohet data dhe sasite e mallrave te furnizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 4, nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Ky kriter është përcaktuar dhe është vertetuar eksperiencën e mëparshme të operatorëve ekonomik.

---

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001: 2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (e vlefshme) **ose ekuivalente e saj.**

Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Çertifikat e siperpermendura jane kerkuar nga ana e AK qe operatoret ekonomik duhet te jene te certifikuar per cilesin e mallrave objekt prokurimi.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

## **NJESIA E PROKURIMIT**